

Lënda: Kthim përgjigje

Z. Hajredin Gega

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me nr.1670 prot., dt:1.03.2023 ju sqarojmë si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dosjes tuaj të përfitimit me numër 134606, konstatoam se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës bazuar në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ju ka caktuar pension pleqërie me 34 vite e 6 muaj periudhë sigurimi, me masë fillestare pensioni 13,637 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 01.09.2016 .

Në lidhje me ankesën tuaj për të përfituar kompensime ju sqarojmë se, me ndryshimet që pësoi ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar, me ligjin nr. 104/2014, u shfuqizuan tre paragrafët e nenit 2 të këtij ligji, të cilët përcaktonin vendosjen e kompensimeve të të ardhurave minimale, duke parashikuar kështu një formulë të re llogaritjeje dhe duke vendosur edhe pensionin social, i cili në vetvete përfshin kompensimet e akorduara më parë për shkak të mos arritjes të standartit minimal nga pensioni bazë.

Sa më sipër, për të gjitha llojet e pensioneve me datë lindje së të drejtës nga data 01.01.2015 e në vijim, nuk do të akordohen kompensimet e parashikuara dhe të akorduara në pensionet me datë lindje së të drejtës deri më datë 31.12.2014, me përjashtim të kompensimeve të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në VKM nr. 565, datë 09.08.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe VKM nr. 8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj".

Duke qenë se jeni banor i Njësisë Administrative Katund i Ri, pra banor fshati, jeni përfitues i vetëm i kompensimit të energjisë elektrike 648 lekë sipas VKM nr. 8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj".

Në përgjigje të ankesës për bashkëshorten tuaj znj. Xhevrije Gega ju informojmë se:

Nga shqyrtimi i dosjes së përfitimit të znj. Gega me numër 144304, konstatoam se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, i ka caktuar pension pleqërie me 21 vite e 3 muaj periudhë sigurimi, me masë fillestare pensioni 8,654 lekë në muaj, me të drejtë pagese nga data 01.04.2019.

Përsa i përket kompensimit të energjisë elektrike sqarojmë se, kompensimi i energjisë përfitohet vetëm nga kryefamiljari, në këtë rast kompensimin e energjisë e përfiton bashkëshort z. Gega.

Lidhur me pretendimin për mospërfshirjen e raporteve të lindjes në llogaritjen e pensionit të znj. Gega, ju bëjmë me dije se, raporti i lindjes për vitin 1984 dhe për vitin 1987 është përfshirë në llogaritjen e pensionit.

Për vitin 1984, znj. Gega figuron me 183 ditë në Kooperativën Bujqësore Okshtun, nga këto 141 ditë janë raport barrë lindje dhe 42 janë ditë pune. Ndërsa për vitin 1987 figuron me 209 ditë në Kooperativën Bujqësore Okshtun, nga këto 142 ditë janë raport barrë lindje dhe 67 janë ditë pune. Në regjistrin themeltar nr.1, faqe 120 të Kooperativës Bujqësore Okshtun, fshati Okshtun i vogël i cili është i çertifikuar nga Drejtoria e Arkivit Qendror nuk rezultojnë ditë të tjera që i përkasin raportit të barrë lindjes.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Dibër nuk disponon bordero për Kooperativën Bujqësore Okshtun, fshati Okshtun i vogël.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.